



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C. nr. 1010/2016

GJYKATA THEMELORE PRIZREN gjyqtari Atdhe Berisha në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësve I.Rr., dhe R.Rr., që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat S.R., nga Prizreni, kundër të paditurit R.Rr., nga fshati, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson H.K., avokat nga Prizreni, për anulimin e testamentit, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor, me datë 28 Janar 2020, merr këtë:

A KT GJYKIM

Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve I.Rr., dhe R.Rr., që të dy nga Prizreni, me të cilin kanë kërkuar "të vërtetohet se testamenti i përpiluar me shkrim në të cilin tani i ndjeri I.R., ish nga fshati, komuna e Prizrenit, ka vënë gishtin tregues, me të cilin testament të paditurit R.R., i ka lënë ngastrën kadastrale nr.ZK Gornje Selo, në vendin e quajtur "Prisoje Ograda", në sipërfaqe të përgjithshme prej 1271 m² nuk prodhon efekt juridik".

Detyrohet paditësi I.R., nga fshatiKomuna e Prizrenit, t'i paguan të paditurit R.R., nga fshati, Komuna e Prizrenit, shpenzimet e procedurës në shumën 675,00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nënë kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.


A r s y e t i m

Paditësi në padi, parashtrësë dhe gjatë seancave, përmes të autorizuarit të vet, sqaron se paditësi është trashëgimtar ligjor i tani të ndjerit I.R.,.

Proceduara e trashëgimisë në lëndën Obr.datë 25.04.2016, është ndërprerë dhe palët janë udhëzuar në kontestin civil.

Sqaron se nga aktvdekja, tani i ndjeri I.R., ka lënë 4 trashëgimtar ligjor dhe atë këtu palët ndërgjyqëse, vajzën B.R., e cila e ka pranuar pjesën e vet. Testamnet lënësi ka ditur shkrim lexim dhe nuk ka pasur nevojë që në testament të vendos gishtin. Asnjëherë në asnjë dokument ai nuk ka vu gisht. Vendosja e gishtit tregues në tregon që testament lënësi ka përpiluar atë testament nën presion dhe mashtrim. thekson se në kohën kur është përpiluar testamenti, i ati i palëve ndërgjyqëse ka dhe nuk ka mundur të kontrollojë veprimet e veta e as i vetëdijshëm se çfarë po n

Gjithashtu pala paditëse sqaron se diku deri kah Viti 1990 palët ndë jetuar në bashkësi familjare. Me punën e tyre kanë sjellë të ardhura personale. Për duke pasur parasysh zakonet atë paluajtëshmëri e kanë regjistruar në emër të babës që në kuptim të dispozitave ligjore të ligjit të trashëgimisë të gjithë trashëgimtarët trashëgojnë në kushte të barabarta, pasi që kanë jetuar në bashkësi dhe kanë krijuar të mira të



përbashkëta. Për këto arsye paditëse ka kërkuar që këtë çështje me të paditurin ta zgjidhin me marrëveshje, ku gjysma e pasurisë do t'i takonte paditësit dhe gjysma tjetër të paditurit.

Paditësi me testamentin i cili kundërshtohet i është cenuar pjesa e e nevojshme, ai është privuar nga pjesa e nevojshme, pasi që paditësi është përjashtuar nga testamenti.

Sqarohet se testamentin alografik, si në rastin konkret, mund ta përpilojë vetëm testament lënësi i cili nuk din shkrim lexim, ashtu që deklarata dhe nënshkrimi në testament duhet të jetë dhënë para dy dëshmitarëve e jo dëshmitarët të nënshkruajnë testamenti. Të gjitha këto e bëjnë testamentin jo të vlefshëm pasi që mungon forma ligjore e përpilimit të atij testamenti.

Dëshmitarët të cilët e kanë nënshkruan testamentin janë sqaruar se nuk e kanë të njohure përmbajtjen e testamentit. Gjithashtu nuk janë sqaruar se me cilin fëmijë ka jetuar testatori, ashtu që propozon që atyre dëshmitarëve gjykata të mos ju kushtoj besimin.

Gjatë fialës përmbyllëse të paraqitur me shkrim, i autorizuari i paditësit e ndryshon kërkesën.

Propozon miratimin e kërkesëpadisë. I kërkon shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme 755,00 € dhe atë për 5 seanca nga 135,00 € për seancë dhe 80,00 € në emër të përpilimit të padisë dhe pagimit të taksës gjyqësore.

I padituri në përgjigjen në padi dhe theksimet gjatë seancave, përmes të autorizuarit të vetë, e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë. Sqaron se pretendimet e palës paditëse sa i përket sëmundjes së testatorit i cili nuk ka mundur të jetë në gjendje të kontrolloj veprimet e veta dhe nëse ka mundë të jetë i vetëdijshëm se çfarë shkruan, janë të pabazuara, pasi që ato pretendime janë në kundërshtim me vetë formën e testamentit. Pasi që testamenti është hartuar në zyrën e avokatit në praninë e dëshmitarëve dhe i vërtetuar nga vet testatori.

Nga vetë përmbajtja e testamentit shihet se testatori I.R., para se të përpilon testamentin dhe të përcakton pjesët e trashëgimisë të cilët do tu len trashëgimtarëve, deklaroi se është në moshën 71 vjeçare dhe është plotësisht i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm për ndarjen e pasurisë. Ashtu që djalit R.R., i lënë ngastrat kadastrale nr. dhe ngastrën kadastrale nr. Ndërsa djalit I.R., lënë ngastrat kadastrale nr., si dhe 1/2 pjesë ideale në ngastrën Djalit të tjetër I.R., i lënë 1/2 pjesë ideale tëngastrës kadastrale nr. Ndërsa vajzës B....., nuk i lënë asgjë.


Pra, i autorizuari të paditurit sqarohet se testatori ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se çfarë po lënë nga pasuria e tij, përmes atij testamenti.

Sqaron se tani i ndjeri, përpiluesi i testamentit, këtë testament personalisht vetë e ka dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prizren, i regjistruar në numrin Ndr., kështu që nëse tani i ndjeri I.R., po të kishte qenë i sëmur, apo po ti mungonte vetëdija dhe po të mos kuptonte veprimet e tija, nuk do të shkonte të avokati I.Q., të përpilonte testament dhe të njëjtin ta dorëzonte në gjykatë.

Propozon refuzimin e kërkesëpadisë. Nuk i kërkon shpenzimet e procedurës.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gi administruar provat: me shikim në Aktvdekjen për I.R.; me shikim në e Gjykatës Themelore në Prizren T.nr.datë 25.04.2016; me shikim në Tes përpiluar nga testatori I.R., datë 20.09.2004; me shikim në parashtresën p dorëzimin e testamentit në gjykatë; me dëgjimin e dëshmitarëve S.D., M.R.; nënshkruar në testamentin e kontestuar, dëshmia e tij përputhet edhe me dëshminë e dëshmitarit S.V.,

Gjykata nuk ka marr për bazë shumë pyetje tjera që ju janë bërë dëshmitarëve sa i përket kontributit, faktit se kush është kujdesur për testatorin, si dhe krijimin e pasurisë, pasi që Objekt kontesti ka qenë anulimi i testamentit sa i përket mungesë së vullnetit të testatorit dhe formës së testamentit.



Nga dëgjimi i palëve ndërgjyqëse I.R., dhe R.R., vërtetohet se babai i palëve ndërgjyqëse, tani i ndjeri I.R., ka jetuar me paditësin I.R.. Gjithashtu është vërtetuar se i padituri R.R., ka jetuar në shtëpinë tjetër.

Nga administrimi me ndërgjegje dhe kujdes të çdo prove veç e veç dhe të gjitha së bashku, të propozuara nga palët ndërgjyqëse, gjykata vendosi që të refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e palës paditëse.

Për palët ndërgjyqëse nuk është kontestuese që tani të ndjerit I.R., ka përpiluar te avokati një testament, me të cilin testament ka bërë ndarjen e pasurisë për fëmijët e tij, I.R., dhe R.R., këtu paditësit dhe R.R., këtu i padituri.

Kontestuese për palën paditëse është forma e testamentit, aftësia e testament aftësia për të përpiluar testament dhe kontributi i paditësve në kujdesin e testamentlënësit, tani të ndjerit I.R.. Bazat mbi të cilat pala paditëse kërkon anulimin e testamentit.

Në kuptim të nenit 56 të Ligjit mbi Trashëgimin (G.Z. KSAK 30/74), trashëgimlënësi mund të bëjë testament duke e nënshkruar me dorë dokumentin që i ka përpiluar dikush tjetër në praninë e dëshmitarëve duke deklaruar se testamenti është i tij. Dëshmitaret duhet të nënshkruajnë vet në testament.

Në rastin konkret trashëgimlënësi I.R., ka përpiluar testament në zyrën e avokatit. Të njëjtin testament e ka nënshkruar duke qitur gisht. Prezent kanë qenë dëshmitaret S.D., dhe E.Q., të cilët kanë nënshkruar testamentin gjithashtu. Ky testament është lënë në ruajtje në gjykatë.

Nisur nga kjo gjendje gjykata konsideron që sa i përket formës së testamentit, nuk ka asnjë të metë. Mbi këtë bazë gjykata konsideron se pretendimi i palës paditëse është i pabazuar.

Duke pasur parasysh se koha kur është përpiluar testamenti, në fuqi ka qenë Ligjit mbi Trashëgimin (G.Z. KSAK 30/74), gjë që gjykata ka zbatuar ato dispozita të atij ligji.

Shkaku i dytë për të cilin kërkohet pavlefshmëria e testamentit, në kuptim të nenit 54 të Ligjit mbi Trashëgimin dhe atë për shkak të paaftësisë së trashëgimlënësit për të gjykuar, është i pabazuar. Në provat që u paraqitën gjatë gjykimit, nuk rezulton që testatorit t'ijetë hequr zotësia për të vepruar me vendim gjykate, gjithashtu nuk u arrit të provohej që i ndjeri I.R., nuk ka qenë në gjendje që të mos kuptojë rëndësinë e veprimeve që kryhen, perkundrazi nga shpjegimet e dëshmitarëve, ai ishte në një gjendje të mirë shëndetësore, dhe nuk paraqiste asnjë çrregullim në fialë apo veprime

Gjithashtu për gjykatën nuk ishin të bazuara pretendimet e palës paditëse lidhur me kontributin në e paditësve në kujdesin ndaj trashëgimlënësit. Detyrimi për kujdes, nga fëmijët për prindërit dhe prindërit për fëmijët nuk është bazë për vërtetimin e pronësisë. Përkundrazi është një detyrim ligjor, detyruar për prindërit dhe fëmijët.

E gjithë pasuria Objekt i testamentit ka qenë e evidentuar në emër të tani të ndjerit I.R.. Me rastin e përpilimit të testamentit testamen lënësi është kujdesur që të tre djemve tu ndaj pasuri, ashtu që paditësit I.R., i ka lënë $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr. ZK Gornje Selo, në sipërfaqe prej 14,51 ari. Paditësit tjetër R.R., i ka lënë shtëpinë me oborr, e evidentuar si ngastër kadastrale nr. ZK Gornje Selo, një pjesë të bahçes në sipërfaqe 1,57 ari, si dhe $\frac{1}{2}$ pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr.

Ndërsa të paditurit i ka lënë ngastrën kadastrale nr. në sipërfaqe 18,61 ari, ngastrën tjetër kadastrale nr. në sipërfaqe 16,55 ari, si dhe ngastrën në sipërfaqe 12,71

Pra trashëgimlënësi përmes testamentit ka bërë ndarjen e pasurisë, sipas vullnetit të lirë të vetë. Mbi këtë bazë gjykata gjen se paditësit nuk janë privuar nga pjesa e domosdoshme që do tu takonte sipas ligjit përkundrazi shprehja e vullnetit e trashëgimlënësit ka qenë e atillë që është munduar që të jetë sa më i barabartë në ndarjen e pasurisë për djemtë e tij.


Vetë fakti që ekzistimi i testamentit, ashtu siç përcaktohet me ligj, është arsye për ndëmrerjen e procedurës së trashëgimisë, tregon rendësin e testamentit, me të cilën shprehet vullneti i testatorit për ndarjen e pasurisë e Cila evidentohet në emër të tij. Është vetë testatori ai i cili dinë se si të administron me pasurinë e tije.

Për shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që pala paditëse ke humbur procesin gjyqësor, ndërsa pala e paditur i ka kërkuar në mënyrë të precizuar shpenzimet e procedurës. Të cilat shpenzime kjo gjykatë i ka pranuar pasi që shuma prej 135,00 € e kërkuar nga pala e paditur, për një përfaqësim, është në përputhje me Tarifën e Odës së Avokatëve.

Nga arsyet e cekura më lartë, gjykata në kuptim të nenit 143 të LPK-së lidhur me nenet 54, 55 dhe 56 të Ligjit mbi Trashëgimin (G.Z. KSAK 30/74), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN C.
nr. 1010/2016 datë 28 Janar 2020

Gjyqtari
Atdhe Berisha



e pakënaqur mund të paraqet ankesë
afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e këtij aktgjykimi.